

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2021

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
01	23.6.2021	Kërkesë për informacion mbi anëtarët e Komitetit të Investimeve Strategjike, mbi numrin dhe listën e projekteve strategjike të miratuara, në mënyrë të veçantë të projekteve që kanë përfituar statusin "procedurë e veçantë", si dhe për rastet kur është trajtuar shpronësimi i pasurisë private dhe kontratat e miratuara nga Kuvendi në funksion të një	6.7.2021	1.Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të tij ka këta anëtarë: a) Zëvendëskryeministrin; b) ministrin përgjegjës për çështjet e financave; c) ministrin përgjegjës për çështjet e ekonomisë dhe turizmit; ç) ministrin përgjegjës për çështjet e infrastrukturës dhe transportit; d) ministrin përgjegjës për çështjet e energjisë dhe industrisë; dh) ministrin përgjegjës për çështjet e zhvillimit urban; e) ministrin përgjegjës për çështjet e bujqësisë; ë) ministrin përgjegjës për mjedisin; f) Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit; g) si dhe, rast pas rasti, ministrat përgjegjës, kur çështjet që do të diskutohen në këtë komitet u përkasin fushave të përgjegjësisë që ata	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		investimi strategjik.		mbulojnë. 2.Që prej momentin të hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 55/2015, AIDA ka trajtuar dhe dërguar në KIS 37 kërkesa për marrje statusi investim/investitor strategjik, prej të cilëve 10 nuk janë miratuar. 3.Në lidhje me pyetjen 3, gjeni në vijim listën e kërkuar. 4. Në lidhje me pyetjen 4, gjeni në vijim informacionin e kërkuar. 5. Pavarësisht parashikimit ligjor lidhur me këtë shërbim ndaj investitorit në rastin e procedurës së veçantë, deri më sot, KIS nuk ka parashikuar, në asnjë prej vendimeve të tij, miratimin e kësaj mase mbështetëse, në vlerësim edhe të parashikimeve të VKM Nr. 1032/2015. 6. Deri më sot, Kuvendi i Shqipërisë nuk ka miratuar asnjë kontratë bazuar në nenin 22, pika b të ligjit nr. 55.2015.		
02	E-MAIL 25.10.2021	<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë politikat e institucionit tuaj në lidhje me nxitjen investimeve nga diaspora shqiptare në vendlindjen e tyre? Ju lutem referoni bazën ligjore/kuadrin rregullator në lidhje me këto politika? • Cilat janë programet dhe shërbimet që ofrohen nga institucioni juaj për emigrantët e kthyer/ apo investitorë nga 	1.11.2021	<p>Pas shqyrtimit të kërkesës, para së gjithash, sjellim në vëmendjen tuaj se:</p> <p>(1) Ligji nr. 7764, datë 2.11.1993 “Për investimet e huaja”, përcakton se:</p> <p>"Investitor i huaj" nënkuptohet:</p> <p>a) çdo person fizik që është shtetas i një vendi të huaj; ose</p> <p>b) çdo person fizik që është shtetas i Republikës së Shqipërisë, por me banim të përhershëm jashtë vendit; ose</p> <p>c) çdo person juridik, që është themeluar sipas ligjit të një vendi të huaj, i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi kërkon të kryejë ose është duke kryer një investim në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet e saj, ose ka kryer një investim në përputhje me ligjet që i përkasin periudhës nga data 31.7.1990 e në vijim.(NENI 1)</p> <p>(2) Ligji nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>diaspora? A ka skema favorizuese për nxitjen e investime nga diaspora shqiptare në vendlindjen e tyre?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa është numri i investitorëve të huaj nga Diaspora që kanë përfituar nga mbështetja e ofruar nga institucioni juaj përgjatë 10 viteve të fundit. Lutem na vini në dijeni për të dhënat e ndara sipas viteve, formës së mbështetjes (financiare, logjistike, burime njerëzore, teknike) tipologjisë së sektorëve ku kanë investuar? • Ju lutem na vini në dijeni të çdo informacioni tjetër në lidhje me përmirësimin e klimës së biznesit dhe nxitjen e investimeve nga diaspora shqiptare 		<p>përcakton se: "Subjekte investuese strategjike" janë subjektet investuese të interesuara për zhvillimin dhe realizimin e një investimi të kualifikuar si strategjik, sipas këtij ligji. Subjekte investuese strategjike mund të jenë personat juridikë privatë, vendas dhe të huaj. (NENI 3, PIKA 17) (3) Në interpretim të sa më sipër, në legjislacionin që rregullon investimet e huaja dhe ato strategjike në Republikën e Shqipërisë (sikurse edhe aktet nënligjore të dala në dhe për zbatim të tyre) nuk e parashikojnë konceptin e "emigrantit të kthyer" apo atë të "investitorit nga diaspora", duke i ndarë investitorët vetëm si "vendas" e "të huaj". Duke pasur parasysh sa më sipër, gjeni, në vijim, përgjigjet mbi informacionet e kërkuara nga ana juaj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në lidhje me pyetjen nr. 1: Agjencia Shqiptare e Zhvillimi të Investimeve (AIDA) nuk ka politika specifike apo të ndryshme nga ato që parashikojnë aktet ligjore në fuqi, për nxitjen e investimeve nga diaspora. Pavarësisht kësaj, ju bëjmë me dije se Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (ADBC) është institucioni më i ri strategjik shqiptar që synon të mbështesë dhe angazhojë komunitetin e biznesit të diasporës shqiptare në zhvillimin e Shqipërisë. ADBC u inagurua në 27 Nëntor 2019 nga Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Kombëtar Shqiptar i Diasporës (për më shumë: https://www.adbc.al/). Ndërkohë që, më datë 14 Shkurt 2020, është nënshkruar një memorandum i bashkëpunimit midis Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të 		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>në vendlindjen e tyre?</p>		<p>Investimeve dhe Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, për bashkërendimin e punës për shtimin e shërbimeve pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës (https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/te-reja-dhe-evente/te-rejat-per-ihd/118-aida-nenshkruan-memorandumin-e-bashkepunimit-me-dhomen-e-biznesit-te-diaspores-shqiptare).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në lidhje me pyetjen nr. 2 Të gjitha shërbimet që ofron AIDA, në bazë të Ligjit nr. 10 303 datë 15.7.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)" (NENET 5, 6, 7, 8, 9), të Ligjit nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (NENI 6), si dhe akteve të dala në dhe për zbatim të tyre (VKM 1025/2015), ofrohen pa dallim dhe janë njësoj për çdo investitor person juridik privat, vendas dhe të huaj (baza ligjore për investimet strategjike gjendet në linkun: https://aida.gov.al/sq/investimet-strategjike/baza-ligjore-per-investimet-strategjike). • Në lidhje me pyetjen nr. 3: AIDA nuk e mbledh dhe nuk e administron një informacion të tillë. Për më shumë informacion mund t'i drejtoheni Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare (https://www.adbc.al/) dhe/ose Agjencisë Kombëtare të Diasporës. • Në lidhje me pyetjen nr. 4: Aktualisht, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka iniciuar projekt-ligjin "Për investimet", i cili synon (1) të përditësojë 		
--	--	-------------------------------	--	---	--	--

			<p>legjislacionin ekzistues të investimeve me standardet më të mira ndërkombëtare; (2) të vendosë një skemë të re ligjore të unifikuar dhe konkurruese për të tërhequr investimet e reja vendase dhe të huaja, po ashtu (3) të garantojë përputhshmërinë me legjislacionin e brendshëm dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.</p> <p>Ky projektligj zëvendëson ligjet ekzistuese e konkretisht ligjin nr. 7764, datë 2. 11. 1993 “Për investimet e huaja” dhe ligjin nr. 55/ 2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, por sjell po ashtu për herë të para barazi dhe mbrojtje të njëjtë si për investimet vendase dhe të huaja, si dhe krijon një mekanizëm më efikas të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në këtë fushë.</p> <p>Konsultimi publik i projekt-ligjit është bërë në periudhën 07.05.2019 - 07.06.2019 por ligji nuk miratuar ende.</p> <p>(Për më shumë gjeni dokumentet përkatëse lidhur me projekt-ligjin dhe konsultimin publik në linkun: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/160)</p> <p>Në çdo rast, për më shumë informacion e të dhëna, mendojmë se duhet t'i drejtoheni institucioneve të Diasporës pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku do të mund të informoheni lidhur me Strategjinë Kombëtare të Diasporës Shqiptare dhe Politikat Shtetërore për Diasporën.</p>	
--	--	--	---	--